



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**K R Y E T A R I**

*Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.1, Tiranë;*

*E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al*

Nr. 1416/6 Prot.

Tiranë, më 24.08.2019

**V E N D I M**  
**Nr. 56, Datë 23.08.2019**

**PËR**  
**AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË "UJËSJELLËS KANALIZIME" SHA**  
**LUSHNJË "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË"**  
**për periudhën nga data 01.01.2017 deri më datën 31.12.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në "Ujësjellës Kanalizime" SHA Lushnjë rezultoi që, ka devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të cilat janë të përhapura dhe nuk janë materiale.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i sigurimit të standardeve dhe Cilësisë si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi zbatimin e përputhshmërisë" të ushtruar në shoqërinë "Ujësjellës Kanalizime" SHA Lushnjë, sipas programit të auditimit nr. 1435/1 Prot., datë 07.01.2019, për veprimtarinë nga data 01.01.2017 deri me datë 31.12.2018, me afat auditimi nga data 10.01.2019 deri datë 15.03.2019.

**II.** Të miratoj opinionin e auditimit dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon:

## OPINIONI I AUDITIMIT

### **Opinionin e kualifikuar i grupit të auditimit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Ujësjetës Kanalizime SHA Lushnjë me kuadrin ligjor dhe rregullator.**

Në opinionin tonë për opinionin e kualifikuar, rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), të cilat në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë të përhapura, nuk janë materiale por janë thelbësore të cilat justifikojnë dhënien e opinionit të kualifikuar.

#### **Baza për opinionin e kualifikuar.**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik *ISSAI 4000*<sup>1</sup>.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

#### **Theksim të çështjes**

Ne duam të tërheqim vëmendjen e përdoruesve për disa çështje të cilat ndikojnë në cilësinë e informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare duke përfshirë dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm dhe mospërputhje të veprimtarisë me aktet ligjore. Konkretisht:

-Dëmet ekonomike të konstatuara janë në vlerën 3,464,203 lekë të cilat kanë ardhur si pasojë e keqmenaxhimit në procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave, për vitin 2018.

-Efekte negative financiare në vlerën 6,396,703 lekë të cilat kanë ardhur si pasojë e blerjes së materialeve mbi nevojat e shoqërisë për vitin ushtrimor.

-Sistemet e kontrollit të brendshëm të implementuara nga institucioni nuk kanë rezultuar në përputhje me kërkesat e kriterëve të përcaktuara për vlerësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për shkak të mungesës së kuptimit të këtyre kriterëve, mosplotësisht të kërkesave për dorëzimin e deklaratave për cilësinë e kontrolleve të brendshme, mosplotësisht dhe mosdorëzimit pyetësorëve të vetëvlerësimit, regjistrimit të risqeve, rregullores pa mbështetje në strukturën organizative, veprimeve rregulluese të kryera nga jashtë, mbajtjes së regjistrimit manual të transaksioneve në ditarë, mungesës së strukturës së auditit të brendshëm.

<sup>1</sup>- "Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta".

## A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** "Ujësjetës Kanalizime" SHA Lushnjë, nuk ka plotësuar detyrimin ligjor për përmirësimin e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë për zbatimin me e rekomandimeve të KLSH-së, të dërguara me shkresën nr. 801/6 prot., datë 28.12.2016 Konkretisht:

-Nga 38 masa organizative të rekomanduara gjithsej, janë zbatuar plotësisht 16, janë në proces zbatimi 9 dhe nuk janë zbatuar 13. Nga 6 masa për shpërbllim dëmi të rekomanduara gjithsej, është zbatuar 1, është në proces zbatimi 1 dhe nuk janë zbatuar 4.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 1 faqe 8-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1- Rekomandimi:** Këshilli i Administrimit të Ujësjetës Kanalizime SHA Lushnjë të analizojë dhe të marrë masa me përgjegjshmëri për zbatimin e rekomandimeve të KLSH për përmirësimin e situatës brenda afateve të përcaktuara, raportimin sipas detyrimeve ligjore pranë KLSH si dhe marrjen e masave konkrete në rast të refuzimit të zbatimit të këtyre rekomandimeve nga ana e stafit të Ujësjetës Kanalizime SHA Lushnjë.

*Menjëherë dhe vazhdimisht*

**2. Gjetje nga auditimi:** Për procedurat e prokurimit të audituara nuk është bërë dokumentimi i përlogaritjes së fondit limit (përjashtuar procedurat e blerjes së karburantit dhe shërbimit me roje private) në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2. Si mungesë e dokumentimit nuk janë reflektuar alternativat e ndjekura për përcaktimin e fondit limit, referencat për elementë të veçantë të kontratave, si dhe nuk garantohet ekonomiciteti në përcaktimin e vlerës. Nuk ka strukturë të posaçme të ngarkuar për përlogaritjen e fondit limit, megjithatë jo në të gjitha rastet, ky proces realizohet nga njësia e prokurimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 26-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1-Rekomandimi:-** Autoriteti kontraktor duhet të marrë masa të zbatojë me përpikmëri përcaktimet ligjore për përlogaritjen e fondit limit, me synim nënshkrimin e kontratave me kosto sa më reale dhe ekonomike për shoqërinë. Përlogaritja të bëhet duke shfrytëzuar të gjitha alternativat që përcaktohen në rregullat e prokurimit publik ku është e mundshme dhe të aplikohet ajo alternativë sipas të cilit fondi limit përcaktohet duke mbajtur në konsideratë faktorin e ekonomicitetit. Përlogaritja e fondit limit duhet të dokumentohet gjatë gjithë procesit.

*Vazhdimisht*

**3. Gjetje nga auditimi:** Në lidhje me procedurat e prokurimit publik është konstatuar se në dy raste konkretisht në procedurën e prokurimit "Shërbim me rojë për vitin 2017" dhe "Blerje klori për vitin 2018", kriteret për kualifikim janë vendosur në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik. Ka patur ankesa për hartimin e dokumenteve të tenderit, të cilat nuk janë marrë në konsideratë. Po ashtu, ka patur ankesa nga operatorët ekonomikë edhe sa i takon procesit të vlerësimit të ofertave por nga ana e komisioneve përkatëse nuk janë shqyrtuar me korrektësi. Komisioni i Prokurimit Publik ka vendosur marrjen në konsideratë të ankesave dhe ka kërkuar rivlerësimin e ofertave nga KVO. Këto mangësi kanë shkaktuar vonesa në zbatimin e procedurave dhe nënshkrimin e kontratave përkatëse (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 26-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1-Rekomandimi:** - Autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për trajnimin e anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe KVO, në mënyrë që hartimi i dokumenteve të tenderit dhe vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomik të bëhet korrekt, në mënyrë që të shmangen vonesat në lidhjet e kontratave për realizimin e shërbimeve, si dhe të sigurohet konkurrencë dhe transparencë në zbatimin e procedurave të prokurimit publik.

*Vazhdimisht*

**4. Gjetje nga auditimi:** Referuar auditimit të kryer për procedurat e blerjeve me vlerë të vogël, në rastet e blerjes së mallrave dhe shërbimeve jo të planifikuara që në fillim të vitit, u konstatua se kërkesa e bërë për mallin apo shërbimin ishte formale pa argumentin e nevojës së kryerjes së shpenzimit dhe ku shpesh here kjo kërkesë kishte thjesht konfirmimin vetëm të titullarit të UKL.

Gjithashtu marrja në dorëzim e mallrave referuar procedurave me blerje me vlerë të vogël konfirmonte thjesht marrjen në dorëzim (konfirmim që e bën dhe magazina me fletë hyrjen e mbajtur) dhe jo marrjen në dorëzim konform specifikimeve dhe kondicioneve të përcaktuara në ftesën për ofertë, detyrim ky i komisionit të blerjeve me vlerë të vogël referuar procedurave të prokurimit publik në fuqi dhe udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 11-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1-Rekomandimi:-** Nga titullari i UK Lushnjë SHA për të shmangur dokumentimin formal e fiktiv, në rastet e miratimit të kërkesës për nevojën e blerjes së mallrave apo shërbime, jo të planifikuara që në fillim të vitit, duhet të kërkojë nga struktura prezantuese të nevojës dhe drejtorisë përkatëse që merret me mbulimin e shërbimeve, dokumentacionin që argumenton nevojën e kryerjes së shërbimit apo blerjes së mallit, konform hapave të hallkave përkatëse në strukture në përputhje me aktet ligjore dhe rregullative në fuqi.

**4.2-Rekomandimi:-**Marrja në dorëzim e mallrave nga komisionet përkatëse të realizohet pas plotësimit të specifikimet teknike të përcaktuara për blerjen e tyre.

**Vazhdimisht**

**5. Gjetje nga auditimi:-**Nga auditimi ka rezultuar se nga UK Lushnjë SHA janë kryer pagesa kundrejt Albtelekom SHA në zbatim të kontratës me nr. 1715 prot., datë 25.03.2016 të Albtelekom sha dhe UK Lushnjë sha nr. 42 prot., datë 25.03.2016, e ndryshuar me aneks kontratën me nr. 4614, datë 07.09.2016 ku afati i saj ka qenë nga data 26.02.2016 deri më 2.08.2018. Gjithashtu referuar nenit 3.12, UK Lushnjë sha do të jetë përgjegjëse për marrjen dhe përdorimin e kartave SIM për 50 numra. Nevoja për kontraktimin e numrave me karta SIM ka rezultuar nga Kontrata e “Instalimit të matësve Elektronikë Wireless” të lidhur ndërmjet UK Lushnjë sha me shoqërinë FMO SHPK dhe shoqërinë INTEGRATED TEKNOLOGZ SERVIS SHPK, e sanksionuar në pikën 5 (Specifikime teknike) të kontratës.

Nga auditimet e mëparshme (ku është konstatuar dhe rekomanduar mos pagesa e kontraktorit për 500 copë sahatë të pavendosur) dhe gjatë këtij auditimi ka rezultuar se nuk ka përfunduar instalimi i sahatëve ku aktualisht gjendja e sahatëve të pa instaluar është 300 copë. Gjithashtu cilësojmë se edhe sahatet e instaluar nuk janë vënë në funksion, pasi nuk kryejnë transmetimin e të dhënave online. *Në këto kushte lidhja e kontratës me Albtelekom nga ish administratori dhe ripërtëritja e kontratës nga administratori aktual për furnizimin me 50 numra për kartat SIM ka qenë jashtë çdo logjike të funksionimit aktual të matësve Elektronikë Wireless.*

Theksojmë se nga shoqëria UK Lushnjë sha nuk na u vu në dispozicion dokument për interesimin shoqërisë për ndërprerjen e kontratave të lidhura, referuar neneve të parashikuara në të dhe në marrëveshje, kundrejt faktit të mungesës së kushteve për marrjen e shërbimit të kërkuar.

Sa më sipër referuar kontratës së parë për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa në shumën 242,718 lekë shumë që konsiderohet dëm ekonomik për shoqërinë për të cilën mbajnë përgjegjësi ish administratori (deri në Dhjetor 2017) dhe administratori aktual z. E.dH (Shkurt i vitit 2018 e vazhdim) për shumat e kaluara për periudhat koresponduese të administrimit të shoqërisë si dhe demin e pa llogaritur dhe të papaguar, nga detyrimet kontraktuale referuar kontratës nr. 826/1 prot., datë 26.09.2018 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 11-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1-Rekomandimi:-**Nga Titullari i shoqërisë të ndërmerret nisma referuar neneve të kontratës Prot. 826/1 datë 26.09.2018, me Albtelekom për ndërprerjen e saj me marrëveshje, pa efekte financiare për shoqërinë, në të kundërt të ndiqen procedurat administrative sipas të gjitha shkallëve të gjyqimit.

**5.2- Rekomandimi:**-Nga Titullari i shoqërisë të bashkëpunohet me shoqërinë FMO, referuar kontratës së lidhur midis palëve dhe aktmarrëveshjes së datës 14.10.2013, për përfundimin e punimeve dhe marrjes në dorëzim të të gjithë produkteve të projektit për ta kthyer projektin (i cili ka likuidim të fondeve kundrejt FMO në masën rreth 95%) në një investim efektiv referuar qëllimit dhe objektivave të këtij financimi.

*Menjëherë*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se UK Lushnjë ka një kredi të nënshkruar me V.B SHA në datën 03.12.2013 në kuadër të financimit të kontratës së lidhur ndërmjet Shoqërisë “Ujësjiellës Kanalizime” SHA. Lushnjë, dhe shoqërive “F” SHPK & “I.T.S” SHPK në datën 14.10.2013, “Për financimin dhe instalimin e një sistemi elektronik për matësit e ujit (EWMS). Në kontratë përcaktohen 72 këste me interesa të llogaritur 4.5 % në vit, kohëzgjatja e kredisë 6 vite, numri i kësteve në vit 12, me datë fillimi të kredisë 01.01.2014, me shumë totale interesi 168,589 euro. Referuar skedulës së pagesave janë paguar detyrimet deri tek kësti i 30-të i kredisë që i korrespondon datës 01.07.2016 dhe kjo pagesë është kryer në datën 20.12.2017, pra janë paguar 478,573Euro (*principal interes, TVSH*) kundrejt detyrimit deri më 31 Dhjetor të vitit 2018 në shumën 1,179,442.46 Euro (*principal interes, TVSH*). Nga auditimi rezulton gjithashtu se ka një ndërprerje të pagesave nga kontrata e Kredisë me V.B dhe nga kjo shoqëri nuk ka rakordim vjetor me bankën pikërisht për detyrimet referuar faktit të mos pagesave të kësteve (nga 31 deri në 72) dhe pagesave jo sipas afateve të përcaktuara në skedulën e pagesave të miratuara nga palët (rakordim për kamat vonesat e llogaritura nga banka) në një kohë që Banka V.B është blerë nga Banka I.S.P dhe veprimet për mbylljen e llogarisë në V.B janë kryer më Tetor të vitit 2018. -Gjithashtu referuar kontratës me FMO dhe ITS për Instalimin e Matësve elektronik Wireless të lidhur me shoqërinë në nenin 8 “Afatet kohore dhe kushtet e pagesës” pika 6 përcaktohet se situacionet duhet të lëshohen nga FMO dhe pranohen nga shoqëria e UK Lushnjë sha.

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga UK Lushnjë, FMO ka paraqitur situacione të cilat janë pranuar nga shoqëria ku janë 5 situacione në vlerën progresive 1,010,000 Euro, kundrejt 1,070,000 euro (kosto e matësve elektronikë dhe e rrjetit të transmetimit e cila nga 720,000 euro është realizuar 660,000 euro në nivelin e 91.67 %. Në një kohë që salla e kontrollit dhe menaxhimi i rrjetit është realizuar në masën 100 % në vlerën 350,000 euro).

Situacionet janë dorëzuar nga FMO dhe miratuar nga supervizori dhe shoqëria UK Lushnjë sha. Referuar situacioneve të paraqitura FMO SHPK ka prerë fatura tatimore për tre situacionet e para në shumën e TVSH 125,000 Euro që i korrespondojnë shumës së situacioneve 625,000 Euro pa TVSH dhe 750,000 Euro me TVSH. Aktualisht referuar pagesave të kredisë në Veneto Bank janë kryer pagesa TVSH në masën 207,167.27 Euro që është më shumë nga TVSH e faturave tatimore të prera dhe dorëzuara në shumën 82,167 Euro (pavarësisht se shumata e paguara u korrespondon situacioneve të miratuara). Nga shoqëria UK Lushnjë SHA nuk ka komunikim zyrtar me FMO për detyrimin e saj të paraqitjes së faturave të TVSH për të gjithë shumën e situacioneve të miratuara dhe të likuiduara (ku përfshihet shumata e situacioneve të likuiduara me TVSH) nga Veneto Bank duke i krijuar kushtet FMO për evazion fiskal në shumën e TVSH 82,167 Euro (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 11-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1-Rekomandimi:**-Nga shoqëria e UK Lushnjë sha të kontaktohet me I.S.B për të përcaktuar detyrimet aktuale të shoqërisë ndaj kredisë së marrë nga V.B (duke përfshirë dhe kamata vonesat) dhe mundësinë e një riskedulimi të kredisë pa kosto shtesë dhe në favor të shoqërisë.

**6.2- Rekomandimi:**- Të njoftohet zyrtarisht dhe të detyrohet FMO për prerjen e faturave tatimore për pjesën e situacioneve të miratuara dhe të rezultuara të pa prera si fatura me TVSH përmbledhëse e shumës së situacionit 4 dhe 5 për të mbuluar TVSH e paguar prej 207,167 euro

(aktualisht prerë fatura tatimore për TVSH 125,000 euro). Në rast të mos reagimit të FMO, të njoftohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për evazion fiskal të FMO në shumën 82,167 euro.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i mbajtjes së dokumentacionit sipas kompetencave dhe rregullshmërisë ligjore rezultoi se kërkesat për karburant bëheshin nga urdhëruesi i punës dhe miratoheshin nga administratori, por shpesh herë këto kërkesa kishin vetëm firmën dhe jo emrat e kërkuësve. Gjithashtu jo gjithnjë në kërkesë vihej arsyeja e nevojës për karburant, sidomos tek makineritë dhe pajisje. Gjithashtu u konstatua se tek mjetet e transportit nuk kishte planifikim mujor të shpërndarjes së karburantit referuar ngarkesës dhe eksperiencës për destinacionin e punës së kryer për çdo mjet. Mjetet furnizoheshin me karburant sipas kërkesave të cilat pothuajse në asnjë rast nuk kishin bashkëlidhur programin e punës së planifikuar për tu kryer.

Nga auditimi i rregullshmërisë së mbajtjes së fletë udhëtimeve rezultoi se kishte raste ku fletët e udhëtimit kishin të paraqitur emrin e shoferit dhe jo konfirmimin e tij. Në disa raste ku fletët e udhëtimit kishin firmën në total muaji të punonjësit udhëtues apo urdhërues dhe jo në çdo ditë të muajit apo destinacionin të realizuar.

Fleta e udhëtimit për një ditë të caktuar paraqiste lëvizjen sipas destinacioneve të kryera atë ditë (pra destinacione të ndryshme), por ky destinacion paraqitej me shumën totale të km të përshkruara dhe jo i veçantë për secilin destinacion, gjë që e bënte të pamundur saktësimin e km të përshkruar.

Nga ana shoqërisë nuk na u vu në dispozicion ndonjë llogaritje e km të miratuara për rrugët rajonale që ndjekin mjetet e shoqërisë për fushën e mbulimit të funksioneve të tyre referuar dhe destinacioneve të vendosura në fletët e udhëtimit.

Në shoqëri nuk kishte rregullore që përcaktonte rregullat në lidhje me përdorimin e mjeteve dhe makinerive si dhe kompetencat për përdorimin e tyre referuar funksioneve dhe detyrave që këto mjete realizojnë, veprime që bien në kundërshtim me udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” pika 35/b, ligjin nr 10296, datë 08.07.2010” Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”neni 4/18 “Kontrolle pas faktit”,neni 4/20 “Mbikëqyrja” dhe nenin 9 pika 2, ku Nëpunësi autorizues propozon akte të brendshme administrative, monitoron dhe përditëson sistemet për menaxhimin financiar dhe kontrollin e njësisë publike (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 11-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1-Rekomandimi-** Nga Titullari i shoqërisë në pozicionin e Nëpunësit Autorizues të hartohet e miratohet një rregullore e cila të përcaktoj rregullat e shpërndarjes në punë të mjeteve të transportit dhe makinerive si dhe kompetencat në hierarki të miratimit të kërkesave për punë të mjeteve si dhe të nevojës së furnizimit me karburant.

**7.2- Rekomandimi:-**Në rregullore të përcaktohen mënyra e plotësimit të fletëve të udhëtimit dhe të fletëve të punës së makinerive dhe pajisjeve ku në çdo rast duhet të plotësohet emri dhe konfirmimi i përdoruesit të mjetit apo makinerisë dhe të punonjësit udhëtues për çdo destinacion të kryer si dhe të mbikëqyrësit të përdorimit të makinerisë.

**7.3- Rekomandimi:-**Fletët e udhëtimit të jenë analitike për çdo destinacion dhe kilometrat korresponduese.

Të hartohet dhe miratohet harta e lëvizjes së mjeteve brenda territorit që mbulon UK Lushnjë sha me shërbimet e saj duke përcaktuar dhe kilometrat përkatëse të destinacioneve.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** - Nga auditimi ka rezultuar se Shoqëria ka Aktive Afatgjata Materiale për të cilat është kryer inventarizimi dhe të cilat përbëhen nga troje 9,396,000 lekë, ndërtesa 169,849,876 lekë makineri e pajisje 1,562,468,519 lekë, mjete transporti 5,903,004 lekë dhe investime në proces 90,770,023 lekë. Për AAM është përdorur në disa raste % amortizimi më e vogël se kufiri fiskal kurse për makineri e pajisje kufiri është më i madh. Përqindjet e amortizimit referuar rekomandimit të lënë nga KLSH në auditimin e mëparshëm janë miratuar nga Këshilli i Administrimit me vendimin nr. 6, datë 24.03.2017 ku për ndërtesa, rrjete ujësjellësi, tubacione, ndërtime e instalime, normat e amortizimit 5 %, për grupin e asetëve makineri e pajisje, normat e amortizimit të janë miratuar në masën 10 %, për pajisjet informatike normat e amortizimit të jenë në masën 25 %. për mjete transporti në masën 10%, për pajisje zyre/inventar ekonomik 10% Vendosja e amortizimit prej 10 % të aktiveve të kategorisë “makineri e pajisje” rezulton i pa argumentuar dhe në kundërshtim me limitin orientues prej 5% të përcaktuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”.

-Gjithashtu nga shoqëria regjistri i Aktiveve nuk është mbajtur sipas pikës 30 të udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve të njësisë në sektorin publik”, të ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 17-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1-Rekomandimi-** Nga Këshilli Administrativ të merret në analizë arsyeja e vendosjes së normës së amortizimit në kundërshtim me aktet ligjore në fuqi dhe të miratohet norma e argumentuar e zërit të AAM “ Makineri e Pajisje” brenda normave orientuese të përcaktuara në ligj si dhe të merret vendimi për bërjen e korrektimeve përkatëse sipas SKK në pasqyrat financiare në vijim.

**8.2.-**Nga Drejtoria Tregtare, Zyra e Financës të përmirësohet mbajtja e regjistrit të aktiveve, duke hedhur në të, AAM të Zonave të Bardha dhe të Ujësjellësit Fshat jo në mënyrë të përmbledhur, por konform listimit të përcaktuar nga eksperti kontabël në raportin e ndarjes përpjesëtimore referuar ndarjes administrative.

*Menjëherë*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se UK Lushnjë nuk ka të kontabilizuar dhe të pasqyruar në të drejtat e arkëtueshme të shoqërisë si për vitin 2016 dhe 2017 kamat vonesat të cilat janë të miratuara nga Enti Rregullator i ujit dhe të sanksionuara në kontratat e klientëve deri në masën 10 % të faturimit mujor dhe që në fund të vitit 2017 janë në masën 23,458 mijë lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me SKK1, paragrafi nr. 54.

-Gjithashtu është konstatuar se ndërmjet sektorit të financës dhe shitjes kryhen rakordime mujore për raportet faturim arkëtim. Rakordimi me raportet e faturim arkëtimit të nxjerra nga sistemi nuk pasqyrojnë kamat vonesat. Kamat vonesat paraqiten nga raporti i ndjekjes së debitorëve. Sistemi i ri i përdorur nga viti 2017 nxjerr raporte jo korrekte në lidhje me debitorët dhe kamat vonesat e tyre, probleme dublimi të cilat kanë ndodhur në momentin e transferimit të të dhënave të debitorëve deri në fund të vitit 2016, gjatë vitit 2017. Referuar të dhënave të raportuara nga shoqëria diferenca midis shifrës së debitorëve të kontabilizuar dhe shifrës së debitorëve me kamat vonesë është 40,234.5 mijë lekë. Nga ana e UK Lushnjë sha ky problem nuk është zgjidhur deri në momentet e këtij auditimi.

-Nga auditimi i pasqyrimit të drejtë të detyrimeve afat gjata dhe afat shkurtra rezultoi se për dy kreditë e KFW dhe FMO nuk është paraqitur drejt detyrimi i kredisë tek detyrimet afatgjata i cili duhej të paraqitej duke zbritur detyrimet për principal deri në momentin e hartimit të pasqyrave financiare, pra deri më 31.12.2017. Detyrimet për principal dhe interesa të viteve të mëparshme të pa likuiduara së bashku me kamat vonesat duhet të shtoheshin tek detyrimet afatshkurtra, pasi në momentin e mbylljes së pasqyrave ato janë kthyer në detyrime të kërkuara dhe njëkohësisht

duhet të kryheshin veprimet përkatëse në llogaritë shpenzuese, veprime të bëra në kundërshtim me SKK1 dhe SKK2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 17-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1-Rekomandimi**-Administratori së bashku me strukturat përkatëse të shoqërisë (IT dhe sektori i shitjes) të zgjidhin problemin e të dhënave jo të sakta të raportuara nga sistemi me firmën instaluese dhe transportuese të të dhënave nga sistemi i vjetër i mbajtjes së të dhënave në aktualin (AI billing), në mënyrë që raportimi të paraqesë me saktësi detyrimet përkatëse.

-Mbas procesit të rakordimit të shifrave nga zyra e financës të kryhet kontabilizimi i kamat vonesave të pa regjistruara në kontabilitet .

-Nga zyra e financës të llogariten drejt detyrimet afatgjata dhe afatshkurtra të shoqërisë duke i pasqyruar ato në kontabilitet konform SKK.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se UKL sha ka në kapitalin dhe rezervat vlerën 301,006,941 lekë si humbje e mbartur e viteve të mëparshme. Gjithashtu kapitali i shoqërisë në fund të periudhës së vitit 2017 është në vlerën 492,343,624 lekë që përfaqëson 58 % të kapitalit të regjistruar. Kjo situatë vazhdon të jetë e tillë dhe gjatë 2018 ku shoqëria vazhdon të jetë me humbje.

Nga Këshilli i Administrimit dhe nga Asambleja gjatë dy viteve ( 2017 dhe 2018) nuk janë kryer analiza dhe plan veprimi konkret (afat shkurtër) për vlerësimin e situatës financiare aktuale të shoqërisë dhe dalje prej saj apo përmirësim të situatës financiare, veprim në kundërshtim me nenin 136 “Mbledhja e asamblesë së përgjithshme”, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pika 3.

Ulja e kapitaleve të shoqërisë nën vlerën e regjistruar është një ndër shkaqet për prishjen e shoqërisë (falimentimin e saj) bazuar në nenin 187 “Shkaqet e prishjes së shoqërisë” të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pika d (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 17-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1 –Rekomandimi:-** Nga Këshilli i Administrimit të merren masat për të realizuar një analizë të thelluar të veprimtarisë së shoqërisë dhe hartimin e plan veprimeve konkrete afatshkurtra e afatgjata me persona përgjegjës për ndjekje e raportim, me qëllim mëkëmbjen e saj referuar parashikimeve ligjore dhe shmangien e shpalljes së falimentimit të shoqërisë, referuar rezultateve financiare të rezultuara deri në fund të vitit 2018.

*Menjëherë*

**11. Gjetje nga auditimi:** Konstatohet se UK Lushnjë në llogaritjen e shpenzimeve për efekte të detyrimeve të pagueshme nuk ka marrë parasysh për vitin 2016 dhe 2017 kamat vonesat e huave në shumën 63,182.01 Euro si dhe nuk ka llogaritje apo rakordim me bankën V.B për të saktësuar apo llogaritur kamat vonesat nga mos pagesat korrektësisht të kësteve të kredisë të marra nga kjo bankë.

Vlera totale e konvertuar me kursin e datës 31.12.2017 është 8,400,047 lekë (pa përfshirë kamat vonesat për mos pagesat e kredisë së marrë nga V.B) janë shpenzime nga kamat vonesa të pa paraqitura në rezultatin e periudhës (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 17-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1 –Rekomandimi:** Nga sektori i financës në fund të çdo periudhe të hartimit të pasqyrave financiare duhet të kryhet rakordimi me institucionet përkatëse (Ministri Financës dhe V.B sot I.S.P) për detyrimet e pa paguara rast pas rasti dhe kamat vonesat e lindura si rezultat i pagesave



jo në kohën e duhur dhe pasqyrimin e tyre korrekt, referuar rakordimit dhe dakordësisë midis palëve, në kontabilitet.

### *Vazhdimisht në çdo fund viti*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se struktura e klientëve debitorë në fund të vitit 2018 paraqitet e tillë ku klientët familjarë zënë 71.3%, entet private 13.4 % dhe entet publike dhe ish komonat 15,3 % të totalit të detyrimit prej 236,483 mijë lekë. Referuar masave të marra nga UK Lushnjë sha rezultoi se për entet publike të cilët paraqiten në shumën pa kamatë vonesa 36,063 mijë lekë nuk kishte asnjë vendimmarrje (këto shuma janë më të lehta për tu arkëtuar se janë detyrime publike). Gjithashtu dhe për entet private të cilët paraqiten në shumën pa kamat vonesë 31,606 mijë lekë pavarësisht masave të marra për ndërprerje të furnizimit me ujë dhe aktmarrëveshjeve të lidhura për një pjesë të klientëve nga UK Lushnjë sha nuk janë ndjekur procedurat ligjore të zbatimit të faturës së ujit si titull ekzekutiv (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 17-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1 –Rekomandimi:**-Nga Administratori i shoqërisë të kryhen të gjitha njoftimet dhe veprimet ligjore për arkëtimin e shumave të klientëve debitorë sidomos enteve publike e private, ku për të gjitha entet publike pagimi i faturave të ujit është specifikuar në aktet e Ministrisë së Financave si pagesë prioritare dhe për mos pagesa të saj bllokohen llogaritë pranë thesareve me paraqitjen listimit të institucioneve publike me detyrime në Degët e Thesareve ku këto institucione publike kryejnë aktivitetin e tyre.

### *Menjëherë*

**13. Gjetje nga auditimi:** -Nga auditimi ka rezultuar se në UK Lushnjë sha jo nga të gjithë komisionet e ngritura për inventarizimin e aktiveve të shoqërisë janë paraqitur për secilin inventar krahas evidencës për krahasimin kontabël e fizik, raporti për Nëpunësin Autorizues konform kërkesave të pikës 85/e të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike, dhe për vërejtjet me karakterin e diferencave dhe dëmtimeve të konstatuara për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, për veprime të mëtejshme.”

Gjithashtu komisioni "Për asgjësimin e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit për vitin 2017", i ngritur me urdhrin nr. 7, datë 22.01.2018 ka vendosur asgjësimin, duke gruposur materialet e përcaktuara të cilat janë në vlerat përkatëse 740,551lekë për inventarin ekonomik dhe 482,200 lekë për inventarin e imët në përdorim, por nuk ka të paraqitur relacion për procesin e asgjësimit në kundërshtim me pikën 110 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011,të ndryshuar. Gjithashtu theksojmë se një pjesë e mirë e materialeve për asgjësim kanë qenë me përbërje metalike dhe duhej të vlerësoheshin si mbeturina të riciklueshme konform pikës 109 të udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 të ndryshuar.

-Komisioni i vlerësimit për vitin 2018 i ngritur me urdhrin nr. 34, datë 13.12.2018 ka shoqëruar vlerësimin e aktiveve për dalje jashtë përdorimit me procesverbale dhe relacionet përkatëse, por në këtë vlerësim dhe raport për AQT në vlerën 2,615,600 lekë (penele, pompa dhe transformatorë) nuk ka të përcaktuar nëse Aktivitetet e vlerësuara duhet të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit nëpërmjet shitjes si material mbeturine apo asgjësimit përfundimtar, në kundërshtim me udhëzimin 30, datë 27.12.2011 të ndryshuar neni 104/pika c.

2-Nga auditimi i dokumentacionit të inventarizimit rezultoi se UK Lushnjë si për vitin 2017 dhe 2018, ka pasur të dhënë në përdorim si inventar të imët ashtu dhe inventar ekonomik (të tretëve) në shumat 220,090 lekë dhe 613,232 lekë. Referuar të dhënave të inventarizimit të vitit 2017 rezulton se për mallrat (karrige, perde, kondicioner tavoline, daljet ishin që nga viti 2008, 2009,

2010,2012, dhe 2015. Dhënia e aktiveve pa pagesë të tretëve bie në kundërshtim me udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar pika 107/b e cila përjashton njësitë e sektorit publik të përcaktuara në nenin 3 pika 2 e ligjit nr 10 296,datë 8.10.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” të japë pa pagesë aktive, qoftë dhe për përdorim të përkohshëm.

3-Në Ujësjiellës Kanalizime Lushnjë sha nuk ka dokument hipotekar që të vërtetojë se AQT të llogarisë “ Ndërtime ” si dhe të Toka troje dhe terrene janë në pronësi apo në administrim të këtij ujësjiellësi. Në Ujësjiellës Kanalizime Lushnjë me procesin e bashkimit të Ujësjiellësve Fshat dhe Zonat e Bardha ( ku në pasqyrat financiare rrjetet e ujësjiellësve janë paraqitur në shumat totale) po bëhet identifikimi i çdo aseti dhe kufitarëve ku më pas do vazhdohet me dokumentacionin, por nga auditimi ka rezultuar se kjo shoqëri është në vështirësi financiare, fakt që ndikon dhe në realizimin dhe hartimin e dokumentacionit të kërkuar nga ZVRPP me ekspertët përkatës.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 17-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1 –Rekomandimi:**-Nga të gjitha komisionet e ngritura nga titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit, vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të AQT të zbatohen me përpikëri të gjitha hallkat dhe procedurat e përcaktuara në aktet në fuqi si pjesë e rëndësishme e procesit.

*Vazhdimisht*

**13.2-** Nga titullari shoqërisë në bashkëpunim me zyrën e financës të bëhet vlerësimi i aseteve në momentin e dhënies në përdorim të tretëve dhe të kryhet kalimi kapital me pagesë të tretëve mbas miratimit nga Këshilli i Administrimit dhe Aksionari të këtij procesi.

*Menjëherë*

**13.3-** Nga Titullari i shoqërisë të miratohet në Këshillin e Administrimit një plan kohor i shoqëruar me efektet financiare për çdo vit, për realizimin e procesit të dokumentimit dhe aplikimit për regjistrim në ZVRPP, për pajisjen me certifikatë të aseteve të shoqërisë në administrim apo pronësi të sajë.

*Menjëherë*

**14.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i administrimit të marrëdhënieve të punës konstatohet se nuk është hartuar një procedurë ose një rregullore për të përcaktuar si do të kryhet rekrutimi i punonjësve. Nuk ka gjurmë në asnjë rast në burimet njerëzore, për nevojat e sektorëve apo drejtorive. Nuk është bërë për asnjë rast shpallja e vendeve vakante dhe as intervistimi apo testimi i kandidatëve. Deri në përzgjedhjen e tyre nuk ka asnjë informacion apo gjurmë si janë kryer këto procedura. Përzgjedhja e punonjësve nuk është bërë në çdo rast në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë, etj.

Në dy raste janë punësuar në pozicionin Ekonomist Faturë/Arkë me arsim të mesëm, në një rast inxhinieri elektrik me Bachelor. Kjo bie në kundërshtim me kriteret e punësimit Nr. 1157 Prot, datë 29.12.2017 “Vendim nr.22, datë 07.12.2017, mbi ‘Miratimin e rregullores për përcaktimin e kriterëve të punësimit sipas pozicionit të vendit të punës” ku specifikohet se për pozicionin e sipër përmendur kriter është “...Diplomë Universitare. Avantazh përbën Diplomë në një nga Degët e Fakultetit Ekonomik. Po ashtu, me vendim Nr. 04, datë 03.03.2018 “Mbi miratimin e strukturës dhe nivelin e pagave për SHA. Ujësjiellës Kanalizime Lushnjë” përcaktohet se për pozicionin e Ekonomiste Faturë/Arkë arsimit është i lartë. Për pozicionin e Inxhinierit Elektrik nuk ka asnjë kriter të përcaktuar. Megjithatë kjo rregullore për përcaktimin e kriterëve është

hartuar më vonë konstatohen mangësi në përshkrimin e kriterëve dhe nuk ka unifikim referuar nivelit të arsimimit për të gjitha pozicionet e punës. Konkretisht nuk është i qartë pozicioni i punës të operatoreve të cilat në strukturë emërtohen si ekonomiste fature/arke, në rregulloren e brendshme dhe atë të kriterëve emërtohen si operatore faturash.

Në rregulloren e miratuar me Vendim Nr. 21, datë 07.12.2017 “Mbi miratimin e rregullore së brendshme për organizimin e “Ujësjetllës Kanalizime” SHA Lushnjë dhe Rregullore së Përcaktimit e Kriterëve të miratuar me vendim nr. 22, datë 07.12.2017, mbi “Miratimin e rregullore së përcaktimit e kriterëve të punësimit sipas pozicionit të vendit të punës” konstatohen mospërputhje midis pozicioneve të punës, emërtimi në strukturë nuk përputhet me emërtimet në rregullore.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1-Rekomandimi:** Nga Administratori i Ujësjetllës Kanalizime SHA Lushnjë dhe Sektori i Burimeve Njerëzore , të merren masa për unifikimin, qartësimin dhe specifikimin e Rregullore së Brendshme me pozicionet e punës në strukturë dhe kriteret e rekrutimit në punë të punonjësve të rinj.

**14.2-** Nga Administratori i Ujësjetllës Kanalizime SHA Lushnjë dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një rregullore të procedurave të rekrutimit të punonjësve të rinj në mënyrë që bëhet sa më transparent dhe i qartë i gjithë procesi.

***Menjëherë dhe vazhdimisht***

**15.Gjetje nga auditimi:** Pasi u audituan me përzgjedhje rastësore 26 dosje personeli, pra 20% e dosjeve në total, konstatohet Administratori z. E.Dh, i emëruar në datën 20.02.2018 dhe Drejtori Teknik z. E.V, në kundërshtim me nenin 18,pika b dhe nenin 19 pika c, VKM Nr. 63, datë 27.01.2016 “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”, nuk janë pajisur me certifikatat përkatëse për aftësimin specifik profesional të tyre, sipas detyrës që do të ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjetllës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotur. Ndërkohë as nuk kanë paraqitur vërtetim nga ministria e linjës për pamundësinë objektive për pajisjen e tyre me këtë certifikatë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1-Rekomandimi:** Nga Administratori dhe Drejtori Teknik i Ujësjetllës Kanalizime SHA Lushnje të merren masa për trajnimin në Ministrinë e linjës dhe pajisjen me certifikatat përkatëse për aftësimin specifik profesional të tyre, sipas detyrës që ushtrojnë, në fushën e menaxhimit të ujësjetllës-kanalizimeve e të trajtimit të ujërave të ndotur.

***Vazhdimisht***

**16. Gjetje nga auditimi:** -Nga auditimi i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, sistemit të kontrollit të brendshëm dhe funksionimit të tij, u konstatua se në përgjithësi elementët e kontrollit të brendshëm nuk kuptohen nga njësia dhe janë të implementuara në shkallë shumë të ulët. Ky fakt provohet nga niveli i ulët i përputhshmërisë me kërkesat e manualit për menaxhimin financiar për kontrollin, ku njësia nuk ka plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit për vitin 2017, ndërsa për vitin 2018 e plotësuan pasi u kërkua nga grupi i auditimit dhe deklaratën e cilësisë së kontrolleve si bazë për vlerësimin e secilit komponent në kundërshtim me Ligjin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit nr. 10296 dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kap V, Shtojca 2.

-Për përbërësit e secilit komponent, nuk ka një rregullore të përditësuar për funksionimin administrativ në përshtatje të strukturës së ndryshuar, nuk janë përmbushur plotësisht detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të

Risqeve, objektivave të vendosura, strategjive të riskut, nuk ka procedura të mirëfillta monitorimi, si dhe nuk funksionon struktura e Auditit të Brendshëm.

- Kanë caktuar koordinatorin e riskut me urdhër Nr. 495 prot., datë 28.02.2018 “Për emërimin e koordinatorit i cili do të hartojë mekanizmat për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar.”, kanë hartuar regjistrin e përgjithshëm të risqeve”. Ky vendim është në kundërshtim me nenin 10 , pika 1 e ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Koordinatori i riskut është nëpunësi i autorizues i njësive publike. Në përmbushje të tij ai mund t’i delegojë disa prej detyrave të veta për koordinimin e riskut një menaxheri tjetër të njësive publike, në varësi të drejtpërdrejtë të tij.*” Punonjësja e emëruar është aktualisht në pozicionin përgjegjës finance duke mos përmbushur kushtet e sipër përmendura nga ligji (*Më hollësisht trajtuar në pikën 9 faqe 46-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1-Rekomandimi:** -Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për të ngritur një sistem eficient të kontrollit të brendshëm e menaxhimit financiar, duke evidentuar problematikat dhe rekomandimet konstatuara si dhe të merren masa për ngritjen e kapaciteteve në drejtim të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

-Nga ana e institucionit të kërkohet kryerja e trajnimeve në Ministrinë e Financave për kuptimin dhe implementimin e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar. Gjithashtu të merren masa për hartimin e një rregullore të re për përcaktimin e saktë të detyrave sipas strukturës së miratuar dhe përcaktimin e marrëdhënieve ndërmjet pozicioneve të punës për çështje të raportimit, delegimit dhe përgjegjësisë, si dhe të regjistrit të riskut e strategjisë së njësive.

-Të merren masat përkatëse për plotësimin e strukturës së Njësive të auditit të brendshëm, sipas nevojave të sektorit që auditohet, referuar natyrës specifike të Ujësjetës Kanalizime SHA. Lushnjë.

-Nga Administratori të merren masa për plotësimin e të gjitha kërkesave të ligjit për menaxhimin financiar në drejtim të përcaktimit të nëpunësit zbatues, procedurave anti korrupsion, delegimit të kompetencave, hartimit të regjistrit të riskut dhe koordinatorit për menaxhimin e tij, etj.

**Menjëherë**

**17. Gjetje nga auditimi:** Anëtarët e Këshillit të Administrimit, të emëruar në datën 26.09.2016, nuk kanë lidhur kontratën e performancës me UKL.

Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Statutin e UKL, neni 21, pika 3, ku cilësohet se: “Anëtarët e Këshillit të Administrimit në momentin e emërimit lidhin një kontratë pune me shoqërinë, në të cilën janë parashikuar kritere të qarta performance që pritjet të arrijë anëtari i Këshillit të Administrimit në terma vjetor. Në Objektivat për performancën (indikatorët) e vendosur në këtë kontratë duhet të miratohen dhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznes-planet e shoqërisë” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2 faqe 8-9 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17.1-Rekomandimi:-** Këshilli Administrimit dhe Administratori i Ujësjetës Kanalizime SHA Lushnjë, të marrë masa të menjëhershme për lidhjen e kontratave të performancës midis anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe Ujësjetës Kanalizime SHA Lushnje e njëkohësisht të miratohen nga Ministria e linjës.

**Brenda datës 31.12.2019**

**18. Gjetje nga auditimi:** Niveli i humbjeve të ujit është në nivel të lartë, pavarësisht përmirësimit pak të ndjeshëm vitin e fundit.

- Niveli i faturimit është në nivel shumë të vogël që vjen si refleksion i humbjeve në nivel të lartë.
- Niveli i arkëtimit është i ulët, si dhe i shoqëruar me debit.
- Nga ana e shoqërisë nuk janë marrë masat e duhura për matjen e konsumit të ujit për përcaktimin sa më të saktë të prodhimit, shpërndarjes, si dhe matjen tek abonenti. Në lidhje me abonentët, nuk janë bërë kontrole periodike të saktësisë së matjes së konsumit për sahatet matëse në disponim.
- Pavarësisht se nuk ka detajim të adresimit të humbjeve, nuk ka një analizë kostoje të shërbimit si dhe nuk ka parametra për përcaktimin e cilësisë së shërbimit të furnizimit me ujë, nga ana e shoqërisë është aplikuar për rritje çmimi të furnizimit me ujë të pijshëm (*Më hollësisht trajtuar në pikën 7 faqe 24-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.1-Rekomandimi:-** Nga ana e shoqërisë duhet të merren masa të vazhdueshme për uljen e humbjeve si teknike ashtu edhe jo teknike, duke ndërprerë lidhjet e ujit dyfishe, si dhe lidhjet e paligjshme dhe uljen e numrit të debitorëve si biznese, institucione apo familjarë.

*Vazhdimisht*

**19. Gjetje nga auditimi:** Në procedurën e prokurimit “Programi i shitjes, blerja e aparaturave në funksion të këtij programi dhe shërbimi i mirëmbajtjes për 4 vjet” është konstatuar se, nga NJP nuk janë zbatuar kërkesat e LPP-së, në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës dhe dokumentimin e saj. Nga NJP është mbajtur procesverbali datë 14.05.2018 “Për përlllogaritjen e fondit limit të prokurimit”, në të cilin është përshkruar vetëm se: “Njësia e prokurimit shprehet se fondi limit i përcaktuar, është mbështetur në Vendimin e Këshillit të Administrimit dhe konkretisht në vendimin nr. 17, datë 27.04.2018.” Nga NJP nuk është bërë asnjë përlllogaritje për kalkulimin e vlerës së fondit limit të përcaktuar në urdhrin e prokurimit (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 26-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**19.1- Rekomandimi:-** Drejtoria e Ujësjellës Kanalizime Lushnjë SHA, njësia e prokurimit, të marrin masa që në të ardhmen, të argumentojë dhe dokumentojë hapat e ndjekur në përlllogaritjen e fondit limit të kontratës.

*Vazhdimisht*

## **B.1 MASA SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:-** Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Programi i shitjes, blerja e aparaturave në funksion të këtij programi dhe shërbimi i mirëmbajtjes për 4 vjet”, lidhur me nr. 640/6 prot., datë 27.06.2018, u konstatua se pajisjet e furnizuara nuk janë marrë sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në kontratë. Konkretisht, nëse krahasojmë të dhënat teknike të pajisjeve sipas tabelës së mësipërme, me të dhënat teknike të pajisjeve PDA në fakt, rezulton se:

-Lidhur me kriterin se aplikacioni duhet të funksionojë në PDA me sistemin Android v 4.4.3 e sipër dhe të jetë me ndërfaqe në gjuhën shqipe (kriter i kërkuar sipas pikës 1 të specifikimeve teknike të kontratës). Nga verifikimi i pajisjeve PDA, nuk rezultoi që ndërfaqet të ishin në gjuhën shqipe. Pra, ky kriter, i kërkuar nga UKL, nuk është i plotësuar.

- Lidhur me kriterin e specifikuar tek tabela e specifikimeve teknike; Memory- Min 2 GB RAM. Nga verifikimi i të dhënave teknike të pajisjeve PDA, rezultoi se këto pajisje, kanë në total RAM

= 1834 MB ose 1,834 GB. Pra, as ky kriter nuk është i plotësuar pasi është kërkuar minimumi 2 GB.

- Lidhur me kriteret ekstra të kërkuara sipas specifikimeve teknike në kontratë, pra për: IP 48 Waterproof, Dirtproof, Shockproof, Pressureproof, Corrosionproof dhe Scratchproof, rezulton se për asnjë nga këto kritere, nuk është bërë testi ose të paktën nuk është përshkruajtur në asnjë procesverbal, se këto teste janë kryer. Pra, marrja e pajisjeve dhe shpërndarja tek faturistët i pajisjeve PDA, është kryer pa verifikuar nëse plotësohen ose jo kriteret sipas karakteristikave teknike të përshkruara në kontratën e lidhur.

-Përsa i përket funksionimit në PDA të aplikacionit, sipas specifikimeve teknike të përshkruara tek neni 9 i kontratës së lidhur, konstatohet se:

-Nuk kryhet sipas përcaktimeve të pikës 1.2, të nenit 9, “Ruajtja e historikut të ndryshimeve” ku përcaktohet se: Sistemi duhet... kur është kryer modifikimi.

-Nuk kryhet sipas përcaktimeve të pikës 2.6, caktimi i zonave të lexuesve. Sistemi duhet të njoftojë nëse në një zonë... i burimeve njerëzore.

-Nuk kryhet sipas përcaktimeve të pikës 2.7, përcaktimi i itinerarit të leximeve për secilin ... për çdo ditë. Sistemi duhet ... të njëjtët abonentë.

-Nuk kryhet sipas përcaktimeve të pikës 2.8, sinkronizimi automatik dhe real time me të dhënat e sistemit aktual të faturimit.

-Nuk kryhet sipas përcaktimeve të pikës 3.2, dërgimi i të dhënave për vendndodhjen gjeografike të lexuesit... sa më të lartë.

-Nuk kryhet sipas përcaktimeve të pikës 3.3, për marrjen e pozicionit gjeografik... e baterisë.

-Nuk kryhet sipas përcaktimeve të pikës 3.4 deri tek pika 3.11, asnjë nga përcaktimet e karakteristikave funksionale të aplikacionit për lexuesit në terren.

-Nuk kryhet sipas përcaktimeve të pikës 4, paragrafi i dytë, shërbimi i kërkuar përse i përket raportimit në sistem në ndërfaqen e administrimit ku duhet të jepet mundësia e paraqitjes në hartë të pozicionit të lexuesit.

Si rezultat, objekti i prokuruar nuk ka arritur të implementohet sipas përcaktimeve të kontratës as në afat dhe as në cilësi shërbimi. Nuk është arritur objektivi dhe qëllimi final i funksionimit të pajisjeve PDA të kërkuara sipas kontratës së nënshkruar. Vlera e likuiduar deri në fund të vitit 2018 nga UKL SHA për llogari të operatorit ekonomik “JEHONA SOFTWARE” SHPK, është 2,592,000 lekë. Kjo vlerë, **prej 2,592,000 lekë, e cila përfaqëson punime/shërbime të pa kryera sipas kushteve të kontratës, konsiderohet dëm ekonomik shkaktuar UKL SHA** dhe duhet ti kërkohet operatorit ekonomik “**J.S**” SHPK (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 26-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1 -Rekomandimi-:** Drejtoria e Ujësjiellës Kanalizime Lushnjë SHA, sektori juridik, të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej **2,592,000 lekë, të konsideruar si dëm ekonomik ndaj operatorit ekonomik “J.S” SHPK.**

**2-Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës nr. 620/6 prot., datë 04.06.2018, me objekt “Blerje pompash”, lidhur midis UKL Lushnjë SHA me përfaqësues administratorin z. E.Dh dhe operatorit ekonomik “P.Xh” SHPK, me vlerë 2,599,000 lekë me TVSH (konform nenit 19 të saj) dhe afat ekzekutimi 30 ditë nga data e nënshkrimit të saj, u konstatua se mallrat e prokuruar kanë ardhur me vonesë në UKL SHA. Sipas fletë-hyrjes me nr. 62, datë 28.07.2018, faturës me nr. 03, datë 28.07.2018 dhe vlerë 2,287,200 lekë me TVSH, është furnizuar një pjesë e mallrave. Në vazhdim, me fletë-hyrjen nr. 73, datë 27.08.2018, faturës me nr. 10, datë 27.08.2018 dhe vlerë 312,000 lekë me TVSH, ka ardhur pjesa e mbetur e mallit. Si rezultat, mallrat e prokuruar, kanë ardhur me vonesa dhe në dy pjesë. Sipas llogaritjeve, vlera e penaltetit

për dorëzim të vonuar është **293,203 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik** (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 26-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1-Rekomandimi:-** Nga UK SHA Lushnjë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 293,203 lekë**, nga Operatori Ekonomik “P.Xh”, për penalitet të pa mbajtur për dorëzim me vonesë të materialeve.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Kontrata “Blerje tubacione të ndryshme për vitin 2018” është nënshkruar me vlerë 5,158,856 lekë. Në nenin 14 "Kushtet e dorëzimit", pika 14.3 përcaktohet: "*Koha e dorëzimit të mallrave do të bëhet brenda 10 ditëve nisur nga data e lidhjes së kontratës*". Tubacionet janë bërë hyrje në magazinën e shoqërisë me faturë nr. 110 dhe 110/1 prot., datë 24.04.2018.

Referuar nenit 25, pika 1.a, për dorëzim të vonuar konkretisht me 10 ditë, **Kontraktori "V"** Sh.p.k duhet të penalizohet me **vlerë 206,354 lekë** [5,158,856 lekë (çmimi i kontratës) x 4/1000 x 10 ditë] (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 26-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1-Rekomandimi:-** Nga UK SHA Lushnjë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 206,354 lekë**, nga Kontraktori “V” Sh.p.k, vlerë e cila përfaqëson penalitet të pa mbajtur për dorëzim të vonuar të furnizimeve.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi që, për procedurën e prokurimit “Blerje klor për vitin 2017 fondi limit është përlllogaritur me vlerë 2,228,000 lekë dhe është miratuar nga Kryetari i Këshillit të Administrimit me Vendim nr. 5, datë 14.02.2017. Për përlllogaritjen e fondit limit është hartuar një relacion për këshillin e administrimit nga znj. R.B, e cila ka bërë edhe përlllogaritjen e fondit. Në dosjen e prokurimit ndodhet vetëm relacioni i mësipërm i pa shoqëruar me asnjë dokument tjetër që vërteton dokumentimin e përlllogaritjes së fondit limit, mbi mënyrën e përcaktimit, alternativat e përdorura etj.

Përlllogaritja e fondit limit është bërë duke aplikuar çmimin 45 lekë për hipoklorit natriumi dhe 240 lekë për hipoklorit kalciumi. Në këtë relacion nuk përcaktohet referenca e çmimeve të aplikuara si dhe metoda e përcaktuar e përlllogaritjes, pra përlllogaritja e fondit limit nuk është dokumentuar.

Në kontratën e realizuar për vitin 2016, gjatë fazës së konkurrimit operatori fitues, ka paraqitur çmimin 23.5 lekë për kilogram hipoklorit natriumi dhe 173.5 lekë për kg hipoklorit kalciumi. Duke marrë në konsideratë sasinë e parashikuar për blerje 40,000 kg dhe 2000 kg hipoklorit kalciumi, rezulton një fond limit me vlerë 1,287,000 lekë.

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Diferenca ndërmjet fondit limit që duhej përlllogaritur krahasuar me vlerën e kontratës së nënshkruar me **vlerë 153,000 lekë** (1,440,000 lekë - 1,287,000 lekë) përbën dëm ekonomik (Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 26-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1-Rekomandimi:-** Nga sektori juridik i UK SHA Lushnjë, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 153,000 lekë**, nga Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. D.Q, znj. E.L dhe znj. R.B, shkaktuar dëm ekonomik, si pasojë e përlllogaritjes së fondit limit në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje klori për vitin 2018, rezultoi që fondi limit është përlogaritur me vlerë 2,260,000 lekë dhe është miratuar nga Kryetari i Këshillit të Administrimit me Vendim nr. 26, datë 29.12.2017. Për përlogaritjen e fondit limit është hartuar një relacion për këshillin e administrimit nga znj. R.B dhe ish administratori i shoqërisë. Përlogaritja e fondit limit është bërë po nga znj. R.B, duke aplikuar çmimin 30 lekë për hipoklorit natriumi (nën sasinë 60000 kg) dhe 200 lekë për hipoklorit kalciumi, në sasinë 2300 kg. Në këtë relacion nuk përcaktohet referenca e çmimeve të aplikuara si dhe metoda e përcaktuar e përlogaritjes, pra përlogaritja e fondit limit nuk është dokumentuar.

Në kontratën e realizuar për vitin 2017, gjatë fazës së konkurrimit operatori fitues, ka paraqitur çmimin 27.5 lekë për kilogram hipoklorit natriumi dhe 170 lekë për kg hipoklorit kalciumi. Duke marrë në konsideratë sasinë e parashikuar për blerje 60000 kg dhe 2300 kg hipoklorit kalciumi, rezulton një fond limit me vlerë 2,041,000 lekë. Kontrata është nënshkruar me vlerë 2,186,000 lekë. Në procesverbalin e hartimit të dokumenteve të tenderit përcaktohet "*Detyrat e njësisë së prokurimit, hartimit dhe hedhje e dokumenteve të tenderit, janë ngarkuar D.Q, E.L dhe K.E, kanë parë dhe kanë analizuar fondin limit dhe janë dakord që ku tender të hidhet në sistemin elektronik të APP*".

Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Diferenca ndërmjet fondit limit që duhej përlogaritur krahasuar me vlerën e kontratës së nënshkruar me vlerë 145,000 lekë (2,186,000 lekë - 2,041,000 lekë) përbën dëm ekonomik (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 26-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1-Rekomandimi:-** Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 145,000 lekë**, nga Njësia e Prokurimit e përbërë nga z. D.Q, znj. E.L dhe z. K.E, shkaktuar dëm ekonomik, si pasojë e përlogaritjes së fondit limit në kundërshtim me rregullat e prokurimit publik.

**6. Gjetje nga auditimi:** Kontrata e furnizimit “Blerje elektromanikota, për vitin 2018” është nënshkruar Ndërmjet UK Lushnjë SHA dhe OE "V" sh.p.k, me vlerë 1,443,657 lekë, me datë 23.04.2018. Në nenin 3 pika 2 përcaktohet se furnizimi do të bëhet brenda 30 ditëve referuar datës së nënshkrimit të kontratës, ndërsa në nenin 14 "Kushtet e dorëzimit", pika 14.3 përcaktohet: "*Koha e dorëzimit të mallrave do të bëhet brenda 10 ditëve nisur nga data e lidhjes së kontratës*".

Elektromanikotat janë bërë hyrje në magazinën e shoqërisë me faturë nr. 31 prot., datë 06.06.2018, konkretisht me 13 ditë me vonesë, referuar datës së përcaktuar në kontratë për realizimin e furnizimit, konkretisht .

Referuar nenit 25, pika 1.a, për dorëzim të vonuar konkretisht me 13 ditë, **Kontraktori "V" Sh.p.k duhet të penalizohej me vlerë 75,000 lekë** [1,443,657 lekë (çmimi i kontratës) x 4/1000 x 13 ditë] (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 26-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1-Rekomandimi:-** Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 75,000 lekë**, nga Kontraktori “V”, penaliteti i pambajtur, për dorëzim të vonuar të furnizimit.



## **B. 2 MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICIENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Kontrata “Blerje tubacione të ndryshme për vitin 2018, është nënshkruar me vlerë 5,158,856 lekë, me datë 04.04.2018.

Nga auditimi rezulton që, deri në momentin e auditimit janë vënë në përdorim tubacione me vlerë 1,833,140 lekë, nga ku rezulton se janë prokuruar materiale të pa nevojshme gjatë vitit financiar, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik", i ndryshuar, pika 10. **Vlera 3,325,716 lekë**, e cila përfaqëson blerje mbi nevojat, përbën shpenzime pa efektivitet.

Kontrata “Furnizim materiale hidraulike është nënshkruar me datë 29.05.2018, me vlerë 2,864,580 lekë. Nga verifikimi i materialeve gjendje në magazinë, rezulton se deri me datë 05.02.2018, janë vënë në përdorim për nevoja të ndryshme të rrjetit të ujësjellësit materiale me vlerë 356,480 lekë. Prokurimi i materialeve të pa nevojshme, përtej nevojave të shoqërisë bie në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 60 "Urdhri i Prokurimit". **Vlera 2,508,100 lekë**, e cila përfaqëson blerje mbi nevojat, përbën shpenzime pa efektivitet (*Më hollësisht trajtuar në pikën 8 faqe 26-46 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1-Rekomandimi:** - Nga ana e shoqërisë në fillim të vitit ushtrimor të bëhen planifikime të sakta për nevoja materiale, për shërbime apo punime, në mënyrë që përdorimi i fondeve të jetë sa më i saktë dhe me efektivitetin e duhur, duke përcaktuar prioritete të qarta për përdorimin e fondeve në dispozicion.

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se se UK Lushnjë sha ka pasur një nivel të lartë të paaftësisë paguese për rrjedhojë gjatë periudhës objekt auditimi ka kryer pagesa për gjoha dhe penalitete në zbatim të vendimeve gjyqësore të fituara nga furnitorët e pa likuiduar në shumat 89,812 lekë (që përfaqësojnë shpenzime përmbarimore) për vitin 2017 dhe 333,934 lekë (që përfaqësojnë shpenzime gjyqi, shpenzime përmbarimore dhe sanksione) për vitin 2018. Sa më sipër shuma **prej 423,846 lekë** konsiderohet efekt financiar negativ për shoqërinë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 6 faqe 17-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 –Rekomandimi:-** Nga Administratori dhe Këshilli i Administrimit të merren masa për të analizuar shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë për mos përdorim me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike në vlerën prej 423,846 lekë, vlerë e cila ka të bëjë pagesat e sanksioneve, përmbarimore dhe të gjyqit qe kanë qenë rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë të Cash-it dhe mospagesave në kohë sipas përcaktimeve kontraktuale të furnitorëve.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se nga UK Lushnjë sha janë kryer pagesa kundrejt Albtelekom sha në zbatim të kontratës me nr. 1715 prot., datë 25.03.2016 të Albtelekom sha dhe UK Lushnjë sha nr. 42 prot., datë 25.03.2016, e ndryshuar me aneks kontratën me nr. 4614, datë 07.09.2016 ku afati i saj ka qenë nga data 26.02.2016 deri më 2.08.2018. Gjithashtu referuar nenit 3.12, UK Lushnjë sha do të jetë përgjegjëse për marrjen dhe përdorimin e kartave SIM për 50 numra. Nevoja për kontraktimin e numrave me karta SIM ka rezultuar nga Kontrata e “Instalimit të matësve Elektronikë Wireless” të lidhur ndërmjet UK Lushnjë sha me shoqërinë F. SHPK dhe shoqërinë I.T.S SHPK, e sanksionuar në pikën 5 (Specifikime teknike) të kontratës.

Nga auditimet e mëparshme dhe aktual ka rezultuar se nuk ka përfunduar instalimi i sahateve ku aktualisht gjendja e sahateve të pa instaluar është 300 copë. Gjithashtu cilësojmë se sahatet e instaluar janë thjesht të instaluar dhe nuk kryejnë transmetimin online të të dhënave, për mos përfundim dhe marrje në dorëzim të projektit( kusht i përdorimit të kartave SIM). *Në këto kushte lidhja e kontratës me Albtelekom nga ish administratori dhe ripërtëritja e kontratës nga administratori aktual për furnizimin me 50 numra për kartat SIM ka qenë jashtë çdo logjike të funksionimit aktual të matësve Elektronikë Wireless.*

Theksojmë se nga shoqëria UK Lushnjë sha nuk na u vu në dispozicion dokument për interesimin shoqërisë për ndërprerjen e kontratave të lidhura, referuar neneve të parashikuara në të dhe në marrëveshje, kundrejt faktit të mungesës së kushteve për marrjen e shërbimit të kërkuar.

Sa më sipër referuar kontratës së parë për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa në shumën 242,718 lekë shumë që konsiderohet dëm ekonomik për shoqërinë për të cilën mbajnë përgjegjësi ish administratori (deri në Dhjetor 2017) dhe administratori aktual z. E.Dh (Shkurt i vitit 2018 e vazhdim) për shumat e kaluara për periudhat koresponduese të administrimit të shoqërisë si dhe dëmin e pa llogaritur dhe të papaguar, nga detyrimet kontraktuale referuar kontratës nr. 826/1 prot., datë 26.09.2018 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 11-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1-Rekomandimi:** -Nga Këshilli Administrativ referuar kompetencave të dhëna nga ligji, të merren në analizë shpenzimet jo efektive për periudhën objekt auditimi të marrjes së 50 kartave SIM me pasojë dëmin ekonomik në shumën 242,718 lekë të shkaktuar nga administratori i mëparshëm dhe aktual dhe ky fakt të bëhet pjesë e vlerësimit negativ të performancës së administratorit aktual për pjesën takuese të përgjegjësisë. Gjithashtu pjesë e përgjegjësisë të bëhet dhe mosveprimet e administratorit deri në momentin e auditimit, ndër të tjera për bërjen efektive të investimit “Instalimi i matësve Elektronikë Wireless” në bashkëpunim me kontraktonin FMO, ndërprerja e pagesave të kësteve të kredisë gjatë 2018 për kredinë e marrë për këtë investim, duke shkaktuar kosto shtesë të pa paguara apo rakorduara me bankën V.B, apo mos ndërprerje të kontratës së lidhur nga ish administratori me Albtelekom për 50 karta SIM, shpenzim për një shërbim të pa konsumuar.

*Menjëherë*

## **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës” i ndryshuar, kontratës kolektive të punës datë 29.10.2018, Neni 14 “Shkeljet dhe masat disiplinore” Pika 2, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, si më poshtë:

### **I. “Vërejtje me shkrim” për:**

#### **1. z. E.V, në cilësinë e Drejtorit Teknik dhe anëtarit të KVO, për arsye se:**

- Për kontratën e furnizimit “Blerje rakorderi për vitin 2018”, është parashikuar furnizim i materialeve përtej nevojave të institucionit për vitin përkatës. Nga vlera e furnizimit 2,864,580 lekë, deri në momentin e auditimit janë përdorur materiale me vlerë 356,480 lekë. Vlera 2,508,100 lekë, e cila përfaqëson blerje mbi nevojat, përbën shpenzime pa efektivitet. Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 60 "Urdhri i Prokurimit".

- Për kontratën e furnizimit “Blerje tuba për vitin 2018”, është parashikuar furnizim i materialeve përtej nevojave të institucionit për vitin përkatës. Nga vlera e furnizimit 4,299,097 lekë, deri në momentin e auditimit janë përdorur materiale me vlerë 1,833,140 lekë. Vlera 3,325,716 lekë lekë, e cila përfaqëson blerje mbi nevojat, përbën shpenzime pa efektivitet. Është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 60 "Urdhri i Prokurimit".

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Ruajtje objektesh, viti 2017”, nga ana e KVO nuk është shqyrtuar siç duhet dokumentacioni i paraqitur nga OE në sistemin elektronik të prokurimeve, duke skualifikuar padrejtësisht dy OE.

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje tubacione për vitin 2018”, nga ana e KVO nuk është shqyrtuar siç duhet dokumentacioni i paraqitur nga OE në sistemin elektronik të prokurimeve, duke skualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomikë.

### **2. Znj. E.B, në cilësinë e hartuesit të specifikimeve teknike dhe administratores së sistemit IT, për arsye se:**

Karakteristikat teknike të pajisjeve, sipas programit “Programi i shitjes, blerja e aparaturave në funksion të këtij programi dhe shërbimi i mirëmbajtjes për 4 vjet”, nuk kanë asnjë hapësirë për zgjedhje. Ato janë fikse. Vetëm një pajisje mund të ketë dimensione fikse, peshë fikse, kamera përpara ose pas fikse apo edhe LCD Display pa asnjë tolerancë. Pra karakteristikat teknike janë të orientuara drejt një produkti të vetëm. Është vepruar në kundërshtim me nenin 23, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, specifikimet teknike, pika 1.

### **3. znj. R.B. në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:**

- Përlllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje klor për vitin 2018”, nuk është argumentuar. Bazuar në kontratat e realizuara me sukses nga AK, vitin paraardhës, si dhe kontratën e nënshkruar ka rezultuar dëm ekonomik me vlerë 145,000 lekë, veprim në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

- Përlllogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje klor për vitin 2017”, nuk është argumentuar. Bazuar në kontratat e realizuara me sukses nga AK, vitin paraardhës, si dhe kontratën e nënshkruar ka rezultuar dëm ekonomik me vlerë 153,000 lekë, veprim në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

### **4. z. K.E, ekonomist, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit.**

- Në procedurën “Blerje klor për vitin 2018”, nga ana e njësisë së prokurimit janë hartuar kritere për kualifikimin në kundërshtim me aktet ligjore, duke përfshirë si kriter “*Nëse është tregtues duhet të disponojë një kontratë me prodhuesin për sasinë e prokuruar të barabartë ose më të lartë nga ajo e kërkuar në këtë procedurë*”, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, neni 44, 46.

- Për procedurat e prokurimit “Zëvendësim i tubit 160 mm në Lagjen “Xhevdet Nepravishta”, “Blerje rakorderi të ndryshme 2018”, “Blerje elektomanikota për vitin 2018” dhe “Blerje motokarro”, nuk kanë dokumentuar përlllogaritjen e fondit limit në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

- Gjatë zbatimit të procedurës “Blerje motokaro”, nuk është bërë ftesë për të paktën 5 OE që operojnë në fushën e shitblerjes së automjeteve, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar neni 39, pika 4.

**5. znj. E.L, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:**

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Ruajtje objektesh, viti 2017”, nga ana e njësisë së prokurimit janë hartuar kritere për kualifikimin në kundërshtim me aktet ligjore, duke përfshirë si kriter "*OE duhet të paraqesë autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi në emër të shoqërisë konform ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, në mënyrë që të garantohet në çdo kohë funksionimi i sistemit të alarmit dhe gatishmëria e personelit pas marrjes së sinjalit nga objekti ku do të kryhet shërbimi, me rreze mbulimi zonën ku do të ofrohet shërbimi qytetin e Fierit*". Pra sa më sipër është kërkuar shërbim roje për qytetin e Fierit dhe jo të Lushnjës.

- Nuk ka dokumentuar përllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit “Blerje klor për vitin 2017”. Bazuar në kontratat e realizuara me sukses nga AK, vitin paraardhës, si dhe kontratën e nënshkruar ka rezultuar dëm ekonomik me vlerë 153,000 lekë, veprim në kundërshtim VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 59, pika 2.

**6. znj. Xh.K, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit dhe KVO, për arsye se:**

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Ruajtje objektesh, viti 2017”, nga ana e njësisë së prokurimit janë hartuar kritere për kualifikimin në kundërshtim me aktet ligjore, duke përfshirë si kriter "*OE duhet të paraqesë autorizim individual nga AKEP për caktim frekuencash për sistem radiokomunikimi dhe alarmi në emër të shoqërisë konform ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, në mënyrë që të garantohet në çdo kohë funksionimi i sistemit të alarmit dhe gatishmëria e personelit pas marrjes së sinjalit nga objekti ku do të kryhet shërbimi, me rreze mbulimi zonën ku do të ofrohet shërbimi qytetin e Fierit*". Pra sa më sipër është kërkuar shërbim roje për qytetin e Fierit dhe jo të Lushnjës.

- Gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit “Ruajtje objektesh, viti 2018” dhe “Rakorderi të ndryshme për vitin 2018”, nga ana e KVO nuk është shqyrtuar siç duhet dokumentacioni i paraqitur nga OE në sistemin elektronik të prokurimeve, duke skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomikë.

**7. z. K.M,**

**8. znj. R.B, në cilësinë e anëtarëve të KVO, për arsye se:**

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Ruajtje objektesh, viti 2017”, nga ana e KVO nuk është shqyrtuar siç duhet dokumentacioni i paraqitur nga OE në sistemin elektronik të prokurimeve, duke skualifikuar padrejtësisht dy OE.

- Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit “Blerje tubacione për vitin 2018”, nga ana e KVO nuk është shqyrtuar siç duhet dokumentacioni i paraqitur nga OE në sistemin elektronik të prokurimeve, duke skualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomikë.

**9. z. M.Ç**

- Gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit “Ruajtje objektesh, viti 2018” dhe “Rakorderi të ndryshme për vitin 2018”, nga ana e KVO nuk është shqyrtuar siç duhet dokumentacioni i

paraqitur nga OE në sistemin elektronik të prokurimeve, duke skualifikuar dhe kualifikuar padrejtësisht operatorët ekonomikë.

#### **D. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien dhe zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte “Vërejtje me shkrim”, për:

**z. D.Q.**, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

**Shënim i Kryetarit:** Përgjatë muajve shtator-tetor kjo praktikë auditimi do të ri kontrollohet nga Drejtori i Departamentit të Sigurimit të standardeve dhe Cilësisë dhe Drejtori i Departamentit në konsultim me praktikantët e tjera të auditimit në këto njësi ekonomike (Ujësjetës-Kanalizime) me qëllim përmirësimin e gjetjeve në të ardhmen në këto auditime, pse jo edhe për këtë periudhë të audituar në këtë auditim. Grupi i kontrollit të cilësisë do bashkëpunojë në analizim edhe me grupin aktual të auditimit (A.T dhe A.T).

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**